

UDHËZIM
Nr. 23, datë 14.10.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 3.4.2015 “PËR
PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË
PËRFUNDIM TË PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË
RREGULLUAR TË MËSUESIT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015, “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, emërtimi “Agjencia Kombëtare e Provimeve” zëvendësohet me emërtimin “Qendra e Shërbimeve Arsimore”.

b) Shtojca nr.1 në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015, “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit”, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregulatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin Parauniversitar dhe Njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini**

SHTOJCA NR. 1

Formimi i numrit unik të lejes për ushtrimin e profesionit të mësuesit.

1 4 0 1 0 0 0 0 0 1

Viti, Kodi i Profilit, numri individual

Viti: përbëhet nga dy shifra të cilat tregojnë vitin e dhënies së provimit të shtetit.

Kodi i profilit: përbëhet nga dy shifra të cilat tregojnë kodin e profilit.

Numri individual: përbëhet nga gjashtë shifra të cilat tregojnë numrin individual të kandidatit duke filluar nga 000001 dhe vazhdojnë në rend rritës.

Kodi sipas çdo profili në profesionin e mësuesit:

1. Gjuhë angleze, kodi 01;

2. Gjuhë italiane kodi 02;
3. Gjuhë frënge kodi 03;
4. Gjuhë gjermane kodi 04;
5. Gjuhë greke kodi 05;
6. Gjuhë shqipe dhe Letërsi kodi 06;
7. Shkenca sociale kodi 07;
8. Histori kodi 08;
9. Gjeografi kodi 09;
10. Histori-Gjeografi kodi 10;
11. Histori-Gjeografi, Edukatë kodi 11;
12. Matematikë kodi 12;
13. Fizikë kodi 13;
14. Matematikë-Fizikë kodi 14;
15. Informatikë kodi 15;
16. Matematikë-Informatikë kodi 16;
17. Kimi, kodi 17;
18. Biologji kodi 18;
19. Biologji-kimi kodi 19;
20. Edukim fizik kodi 20;
21. Arte figurative kodi 21;
22. Muzikë kodi 22;
23. Arsim fillor kodi 23;
24. Arsim special kodi 24.